

L I G J
Nr.7495, datë 2.7.1991

PER ORGANIZIMIN E SHERBIMIT INFORMATIV KOMBETAR

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Sherbimi Informativ Kombetar eshte organ i specializuar informativo-gjurmues, pjese perberese e Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise.

Sherbimi Informativ Kombetar ka per detyre te parandaloje, zbuloje e nderprese veprimtarine antikushtetuese qe cenon lirine, pavaresine, aftesine mbrojtese, teresine territoriale dhe pasurine kombetare te Republikes se Shqiperise e qe zhvillohet nepermjet formave te spiunazhit, diversionit, sabotimeve, korruptimit politik e ekonomik, rezimit me dhune te vednit kushtetues, pergatitjes per provokimin e luftes dhe prerjen e marredhenieve diplomatike te Republikes se Shqiperise me shtete te tjera, tjetersimin e territorit ose prekjen e kufijve te shtetit, krime keto te parashikuara ne Kodin Penal.

Neni 2

Sherbimi Informativ Kombetar eshte institucion qendror qe varet nga Keshilli i Ministrave.

Sherbimi Informativ Kombetar i raporton Keshillit te Ministrave per ceshtjet qe mbulon, per gjendjen e sigurise ne vend ose ne nje njesi te vecante administrative per problemet e perfunduara dhe per menyren e perdorimit te mjeteve monetare e materiale qe i jane dhene.

Kryetarit te Keshillit te Ministrave i takojne atributet e drejtimit, te pergjegjesise politike dhe te veprimtarise informative ne mbrojtje te interesave te rendit kushtetues demokratik dhe institucioneve te caktuara me Kushtetute.

Neni 3

Vepritaria e ketij organi bazohet ne zbatimin e Kushtetues e te ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe ne respektimin e lirive e te te drejtave universale te njeriut, qe garantohen nga ligjet e shtetit shqiptar te mbeshtetura ne Karten e OKB-se,KSBE- se dhe ne dokumentat e tjera ndermkombetare.

Ne interes te rendit kushtetues dhe te sigurise te gjithe shoqerise, ky organ eshte i depolitizuar. Veprimtarine e tij e organizon dhe e zhvillon jashte ndikimeve te partive e te organizatave politike.

Titullari i ketij organi nuk mund te beje pjese ne asnje parti ose organizata politike.

Objektiviteti, sekteri i punes dhe pasqyrimi i se vertetes jane perimet baze te veprimtarise se ketij organi.

Neni 4

Ky organ i realizon detyrat e ngarkuara me kete ligj nepermjet perdorimit te formave, metodave dhe mjeteve te percaktuara ne vendim te Keshillit te Ministrave.

Kur ne veprimtarine e tij, per te permbushur detyrat qe i ngarkohen nga ky ligj, Sherbimi Informativ Kombetar eshte i detyruar te cenoje te drejtat qe qytetareve u njihen me Kushtetute, kjo veprimtari duhet te miratohet nga Prokurori i Pergjithshem.

Prokurori i Pergjithshem ose zevendesi me autorizimin e tij, kane te drejte te kontrollojne zbatimin e ligjishmerise ne veprimtarine e Organit te Sherbimit Informativ Kombetar. Ne rastet kur ka ankim nga shtetasit per shkelje te ligjit, Prokurori i Pergjithshem mund te autorizojë edhe prokurorin e rrethit.

Neni 5

Per kryerjen e detyrave te parashikuara ne nenin 1 te ketij ligji. Organi i Sherbimit Informativ Kombetar mbeshetet edhe ne ndihmesen e lire te shtetasve mbi moshen 18 vjec dhe forcen detyruese te ligjit, ne perputhje me Kodin Penal te Republikes se Shqiperise.

Neni 6

Sherbimi Informativ Kombetar, per plotesimin e detyrave te tij, bashkevepron me Ministrine e Rendit Publik, Ministrine e Mbrojtjes, organet e drejtesise si dhe koordinon me organe e institucione shteterore e private, sipas kriterave te percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave.

Neni 7

Asnje veprimtari nuk mund te kryhet nga ky organ ne kundërshtim me parimet, normat dhe qellimet e percaktuara me kete ligj.

Neni 8

Organeve te Sherbimit Informativ Kombetar u ndalohej te organizojne punen informative ne seline e Kuvendit Popullor Presidence, Keshillin e Ministrave, ministrite dhe institucionet e tjera qendrore si dhe ne selite e partive politike te degeve te tyre ne rrethe.

Ndalohej kryerja e veprimeve nga Organet e Sherbimit Informativ Kombetar ne drejtim te deputeteve te Kuvendit Popullor, Presidentit, anetareve te Keshillit te Ministrave dhe kryetareve te partive politike, me perjashtim te rasteve kur per kete eshte marre miratim i vecante sipas rastit nga Kryesia e Kuvendit Popullor, Presidenti dhe Kryeteri i keshillit te Ministrave.

KREU II

ORGANIZIMI I SHERBIMIT INFORMATIV KOMBETAR

Neni 9

Organi i Sherbimit Informativ Kombetar ndertohet mbi bazen e ndarjes administrative territoriale dhe vepron sipas parimit te drejtimit unik. Ai perbehet nga Sherbimi Informativ Kombetar ne qender dhe deget e Sherbimit Informativ Kombetar ne njesite territoriale, te cilat varen drejtpersedrejti nga ai.

Kryetari i Sherbimit Informativ Kombetar emerohet e shkarkohet nga Presedenti i Republikes se Shqiperise, me propozim te kryetarit te Keshillit te Ministrave. Zevendesi i tij emerohet e shkarkohet nga Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise. Kuadrot e tjere te hallkave qendrore e lokale emerohen nga kryetari i sherbimit Informativ Kombetar.

Kryetari i Sherbimit Informativ Kombetar dhe kryetaret e degeve te ketij sherbimi ne njesite territoriale pergjigjen per gjithe veprimtarine e organit qe kane ne vartesi.

Neni 10

Kompetencat e Kryetarit të Sherbimit Informativ Kombetar, miratohen nga Kryetari i Keshillit të Ministrave, kurse ato të hallkave vartese nga titullari i organit qendror.

Organizimi i Sherbimit Informativ Kombetar dhe i degeve në njesite territoriale është në kompetencë të kryetarit të Sherbimit Informativ Kombetar.

Neni 11

Sherbimi Informativ Kombetar është person juridik. Fondet monetare e materiale në përdorim të tij mbulohen vetëm nga buxheti i shtetit.

Menyra e administrimit dhe e përdorimit të mjeteve monetare e materiale përcaktohen me vendim të Keshillit të ministrave.

Neni 12

Organi i Sherbimit Informativ Kombetar për funksionimin normal dhe kryerjen me efektivitet të detyrave të tij, me miratim të Kryetarit të Keshillit të Ministrave, përdor mundësitë që kanë institucionet e tjera të administratës shtetërore.

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHERBIMIT INFORMATIV KOMBETAR DHE TE PUNONJESVE TE TIJ.

Neni 13

Sherbimi Informativ Kombetar ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga personat fizikë a juridikë prova materiale dokumente që lidhen me kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenin 1 të këtij ligji, në bazë të Kodit të Procedurës Penale.

Sherbimi Informativ Kombetar, në rastet kur personi gjendet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së veprës penale të parashikuara në nenin 1 të këtij ligji, detyrohet të kryejë të gjitha veprimet sipas Kodit të Procedurës Penale për organet e gjurmimit.

Neni 14

Punonjësit e Organit të Sherbimit Informativ Kombetar kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjetet e nderlidhjes dhe të transportit të personave fizikë a juridikë (me përjashtim të mjeteve të trupit Diplomatik) për të kryer detyra të ngutshme sherbimi, mbasi paraqesin dokumentin përkatës, duke leshuar vërtetim me shkrim dhe duke kthyer vlerat në të holla për shpenzimin e kryer.

Neni 15

Organi i Sherbimit Informativ Kombetar merr kallezimet e deklaratimet që bëjnë personat fizikë a juridikë për veprat penale të parashikuara në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 16

Sherbimi Informativ Kombetar, pasi ka grumbulluar prova të mjaftueshme se subjekti ka kryer një nga veprat penale të parashikuara në nenin 1 të këtij ligji, ua kalon ceshtjen organeve përkatëse.

Ky organ nuk ka të drejtë të kryejë veprime hetimore.

Neni 17

Kur shtetasi qe bashkepunon me organin e Sherbimit Informativ Kombetar semuret, plagoset, behet i paaftë ose humbet jeten per arsye sherbimi, ai ose familja e tij gezojne te gjitha te drejtrat qe parashikohen ne ligjin per Sigurimet Shoqerore e Shteterore.

Neni 18

Punonjesit e Organit te Sherbimit Infomarmativ Kombetar i ploteson detyrat ne baze te ketij ligji. Ai mban pergjegjesi disiplinore administrative e penale, kur vepron ne kundershtrim me permbushjen e detyres qe i eshte ngarkuar.

Neni 19

Punonjesi i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar nuk zbaton asnje urdher qe eshte i paligjshem.

Neni 20

Punonjesit i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar detyrohet te ruaje me rreptesi sekretin shtetror, si gjate kohes qe eshte ne sherbim aktiv, ashtu edhe kur shkeput marredheniet e sherbimit me kete organ.

Neni 21

Punonjesit i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar pajiset me dokument identiteti zyrtar, te cilin e paraqet gjate kryerjes se detyres.

Punonjesi mban arme dhe e perdor ate ne perputhje me ligjin.

Neni 22

Kur e kerkojne interesat e sherbimit, punonjesi i organit te sherbimit Informativ Kombetar eshte i detyruar ti kryeje detyrat zyrtare edhe pas kohes normale te punes.

Punonjesi i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar eshte i detyruar ta kryeje me perpikmeri e deri ne fudn detyren e ngarkuar dhe, po qe nevoja,duke dhene edhe jeten.

Punonjesi i ketij organi, kur ndodhet i pranishem ne rastet kur kryhen krime nga persona te ndryshem, detyrohet te marre masat e nevojshme sipas kodit te procedures penale deri sa te mberijne organet e ruajtjes se rendit ose te hetuesise.

Neni 23

Punonjesi qe merret ne Organin e Sherbimit Informativ Kombetar, duhet te plotesoje keto kushte :

- a) te jete shtetas i Republikes se Shqiperise
- b) te kete figure te paster morale dhe shoqerore,
- c) te mos jete i denuar ose ne ndjekje penale
- d) te kete mbaruar arsimin perkates sipas vendit te punes
- e) te jete i afte nga ana psikike e fizike
- f) te zoteroje te pakten nje gjuhe te huaj.

Neni 24

Organi i Sherbimit Informativ Kombetar duhet te nderprese marredheniet e punes me punonjesit ne keto raste :

- a) kur verehet se prej tij, ne kohen e marrjes ne sherbim jane paraqitur te dhena te rreme;
- b) kur shkel rende ose ne menyre te perseritur disiplinën ne sherbim;
- c) kur kryen veper penale qe denohet me heqje lirie te vertetuar me vendim te formes se prere te gjykates ;
- d) kur i mungojne kushtet e parashikuara nga neni 23 i ketij ligji ose nuk permbush detyren ;
- e) kur mbush moshen per pension te plote pleqerie ;
- f) kur kerkohet nga vete punonjesi dhe miratohet nga organi perkates;
- g) kur shkel ligj.

Punonjesi i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar ka te drejte te ankohet te Kryetari i Keshillit te Ministrave brenda 10 diteve nga data e komunikimit te nderprerjes se marredhenieve te punes, vendimi i te cilit eshte i formes se prere.

Neni 25

Emerimi dhe levizja per punonjesit e Organit te Sherbimit Informativ Kombetar mbi bazen e kriterëve te normuara per kualifikimin e punonjesve.

Neni 26

Punonjesi i Organit te Sherbimit Informativ Kombetar gezon te gjitha te drejtat qe parashikon ligji " Per statusin e Ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise".

Neni 27

Organizimi i Sherbimit Informativ Kombetar behet mbi bazen e ketij ligji.

Struktura e deritanishme e Sigurimit te Shtetit shperbehet.

Ne Sherbimin Informativ Kombetar nuk duhet te punojne persona per te cilet eshte vertetuar se kane shkelur ligjet qe rregullojne veprimtarine e ketij organi.

Organizimi dhe struktura e organeve te Sherbimit Informativ Kombetar percaktohet sipas kriterëve te Keshillit te Ministrave.

Neni 28

Aktet e deritanishme, mbi te cilat eshte ndertuar puna e organeve te Sigurimit te Shtetit shfuqizohen.

Ngarkohet Keshilli i Ministrave te nxjerre vendimet qe parashikohen ne kete ligj dhe Kryetari i Sherbimit Informativ Kombetar te nxjerre rregullore, udhezime dhe urdhera ne zbatim te tij.

Neni 29

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
RAMIZ ALIA

